

AUTO SHKOLLA

ART

www.art.com.mk



www.art.com.mk

2020

АВТО ШКОЛА AUTO SHKOLLA

ART



☎ 042 216 211
☎ 070 370 200

☎ 070 999 779
☎ 071 774 477

fb.com/autoshkollaart @autoshkollaart

email : info@art.com.mk © since... 1995



637. (kat. Ц,Ц1)

Takografi“ është pajisje e cila siguron më së paku shënimin e:

- shpejtësisë së lëvizjes së automjetit dhe të etapës kohore punuese të shoferit ✓
- të dhënave për vend pozitën e automjetit gjatë kohës së lëvizjes
- harxhimit të lëndës djegëse sipas kilometrave të kaluar

3 поени

638. (kat. Ц,Ц1)

„Automjeti transportues i mallrave“ është automjet motorik i dedikuar për:

- transport të personave
- transport të mallrave dhe sendeve ✓
- transport vetëm të substancave të rrezikshme

3 поени

639. (kat. Ц,Ц1)

“Raporti Evropian për fatkeqësi në komunikacion“ është formular i përgatitur nga Zyra Nacionale për sigurim në RM, i cili në rast fatkeqësie të komunikacionit me dëmtim të vogël material e plotësojnë:

- pjesëmarrësit në fatkeqësinë e komunikacionit ✓
- përfaqësuesit e kompanive të sigurimit
- anëtarët e policisë së komunikacionit

3 поени

640. (kat. Ц,Ц1)

Masa më e madhe e lejuar është:

- automjeti me rezervuar të mbushur me karburant
- ngarkesa që mund të bartet
- automjeti bashkë me peshëmbajtjen e tij ✓

3 поени

641. (kat. Ц,Ц1)

Sipas deklaronit të prodhuesit të automjetit”peshëmbajtja”është masa e lejuar:

- në automjet të zbrazët me rezervuar të plotë
- në automjet të zbrazët ku me shoferin pesha mesatare e të cilit është 75 kg.
- me të cilën automjeti guxon të mbingarkohet ✓

3 поени

642. (kat. II,II1)

Automjet transportues i mallrave në defekt në rrugë mund të tërhiqet me:

- me ndihmën e litarit
- me ndihmën e lidhjes së fortë (bigës) ✓
- me ndihmën sajllës

3 поени

643. (kat. II,II1)

„Rimorkio e lehtë“ është mjet, masa më e madhe e lejuar e të cilit:

- nuk është më e madhe se 750 kg ✓
- jo më e madhe se 1.000 kg
- jo më e madhe se 1.500 kg

3 поени

644. (kat. II,II1)

Çdo shofer pas marrjes së patentë shoferit të kategorisë “C”, pavarësisht nga ajo që tani më e ka atë të kategorisë “B”:

- llogaritet për shofer – fillestar, në periudhë prej dy vitesh nga marrja e patentë shoferit ✓
- nuk llogaritet për shofer – fillestar, meqenëse paraprakisht ka përvojë shoferi
- llogaritet për shofer fillestar në periudhë vetëm prej një viti nga skadimi i saj

3 поени

645. (kat. II,II1)

„Marrëveshja Evropiane“ për transport rrugor ndërkombëtar të materieve të rrezikshme është e njohur me shkurtesën:

- CMR
- TIR
- ADR ✓

3 поени

646. (kat. II,II1)

„Mjet bashkëngjites“ është:

- automjeti motorik që tërheq rimorkio të lehtë
- mjeti i cili është i konstruktuar që të tërhiqet nga automjeti motorik ✓
- automjeti tërheqës, masa e përgjithshme e të cilit nuk është më e madhe se 750 kg

3 поени

647. (kat. Ц,Ц1)

Masa më e madhe e përgjithshme e lejuar e automjeteve motorike dhe grup automjetesh nuk guxon të jetë më e madhe se:

- 38 ton
- 40 ton ✓
- 42 ton

3 поени

648. (kat. Ц,Ц1)

Masa më e madhe e përgjithshme e lejuar e automjetit transportues të mallrave me dy boshte nuk guxon të jetë më e madhe se :

- 12 ton
- 18 ton ✓
- 24 ton

3 поени

649. (kat. Ц,Ц1)

Masa më e madhe e përgjithshme e lejuar e automjetit transportues të mallrave me tre boshte nuk guxon të jetë më e madhe se:

- 18 ton
- 24 ton
- 25 ton ✓

3 поени

650. (kat. Ц,Ц1)

Ngarkesa më e madh e lejuar boshtore te automjetet motorike me një bosht pa fuqi lëvizëse është:

- 8 ton
- 10 ton ✓
- 11,5 ton

3 поени

651. (kat. Ц,Ц1)

Gjatësia më e madhe e lejuar e rimorkios është:

- 10 m
- 12 m ✓
- 16,5 m

3 поени

652. (kat. II,II1)

Masa ma e madhe e përgjithshme e lejuar e rimorkios me tre boshte është:

- 12 ton
- 24 ton ✓
- 28 ton

3 поени

653. (kat. II,II1)

Masa më e madhe e lejuar e rimorkios me dy boshte është:

- 18 ton ✓
- 15 ton
- 12 ton

3 поени

654. (kat. II,II1)

Gjatësia më e madhe e lejuar e automjetit motorik ngarkues me rimorkio, është:

- 16,75 metra
- 17,75 metra
- 18,75 metra ✓

3 поени

655. (kat. II,II1)

Përveç tjerash, pllaka e detyrueshme e automjetit është e nevojshme që të përmbajë të dhëna edhe për:

- numrin e rrotullimeve të motorit të automjetit
- pronarin e automjetit, personin fizik apo juridik
- mbi ngarkimet më të mëdha të lejuara në boshtet dhe masën më të madhe të përgjithshme të automjetit ✓

3 поени

656. (kat. II,II1)

Retarder, gjegjësisht ngadalësues për ngadalësim afatgjatë të automjeteve motorike, patjetër duhet të kenë automjetet motorike, masa e përgjithshme e të cilave ka mbi:

- nëntë ton ✓
- shtatë ton
- pesë ton

3 поени

657. (kat. Ц,Ц1)

Automjetet transportuese të mallrave, ku masa ma e madhe e lejuar e të cilave është më e madhe se 10 ton, në pajisjen e tyre duhet të kenë:

- një aparat prej 6 kg. për shuarjen e zjarrit
- dy aparate prej 6 kg. për shuarjen e zjarrit ✓
- dy aparate prej 3 kg për shuarjen e zjarrit
- një aparat prej 9 kg. për shuarjen e zjarrit

3 поени

658. (kat. Ц,Ц1)

Automjetet e transportuese të mallrave nëse tërheqin mjet bashkëngjites në pajisjen e tyre patjetër duhet të kenë:

- një trekëndësh sigurie
- dy trekëndësha sigurie ✓
- një trekëndësh sigurie dhe tabelë për automjet të ndalur
- tabelë për automjet të ndalur në rrugë

3 поени

659. (kat. Ц,Ц1)

Dy pyka shtruese në pajisjen e tyre të obliguar, patjetër duhet t'i kenë automjetet motorike dhe mjetet bashkëngjitesë ku masa më e madhe e lejuar tejkalon:

- 3 ton
- 3.5 ton
- 5 ton ✓
- 7.5 ton

3 поени

660. (kat. Ц,Ц1)

Në pajisjen e tyre të obliguar automjetet transportuese të mallrave, ku masa ma e madhe e lejuar e të cilave është më e madhe se 3.500 kg patjetër duhet të kenë:

- litar çeliku në gjatësi prej 3 deri në 5 metra
- litar elastik për tërheqje
- sajllë për tërheqje
- lidhje të fortë (bigë) për tërheqje ✓

3 поени

661. (kat. II,II1)

Thellësia minimale e larave (gjurmëve) të gomave dimërore, te automjetet motorike ku masa më e madhe e lejuar është më tepër se 3.500 kg është:

- 2 mm
- 3 mm
- 6 mm ✓
- 8 mm

3 поени

662. (kat. II,II1)

Thellësia e larave të gomave te automjetet për transport të mallrave nuk guxon të jetë më e vogël se:

- 1 mm
- 2 mm ✓
- 4 mm
- 5 mm

3 поени

663. (kat. II,II1)

Automjetet ngarkuese, masa më e madhe e të cilave është deri më 10 ton, në pajisjen e obliguar duhet të kenë edhe:

- një aparat prej gjashtë kilogramësh për shuarjen e zjarrit ✓
- dy aparate prej nga gjashtë kilogramësh për shuarjen e zjarrit
- një aparat prej nëntë kilogramësh për shuarjen e zjarrit

3 поени

664. (kat. II,II1)

Në rrugë jashtë vendbanimit, shoferi me automjetin nuk guxon të lëvizë me shpejtësi më të madhe se:

- 80 km/h
- shpejtësia e caktuar me shenjën e komunikacionit të vendosur në rrugë ✓
- 80 % nga shpejtësia e kufizuar për atë kategori automjesh

3 поени

665. (kat. II,II1)

Automjetet për ndihmë në rrugë, automjetet për mirëmbajtje të rrugëve dhe automjetet që përcjellin automjete me të cilat bëhet transport i jashtëzakonshëm, patjetër duhet të kenë të instaluar më së paku:

- një dritë rrotulluese me ngjyrë të kaltër
- një dritë rrotulluese me ngjyrë të verdhë ✓
- dy drita rrotulluese, nga të cilat njëra me ngjyrë të kal

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



666. (kat. II,II1)

Gjatë kryerjes së transportit të brendshëm të mallit, përveç licencës transportuesi në automjet është i detyruar të ketë:

- urdhëresë udhëtimi dhe fletë ngarkesë ✓
- CEMT leje
- TIR karnet

3 поени

667. (kat. II,II1)

Ngarkesa e automjetit nuk guxon ta kalojë pikën më të largët të pjesës së parme të automjetit më shumë se:

- 1 metër ✓
- 1.5 metra
- 1,6 metra
- 2 metra

3 поени

668. (kat. II,II1)

Pika më e nxjerrur e ngarkesës që bartet me automjetin ngarkues dhe e kalon për më shumë se 1 metër pikën më të largët të anës së pasme të automjetit, shënohet me:

- pëlhurë të kuqe
- tabelë në formë katrori e ngjyrosur me vija të pjerta paralele me ngjyrë portokalli dhe të bardhë ✓
- dritë dhe materie reflektuese me ngjyrë portokalli
- trekëndësh sigurie

3 поени

669. (kat. II,II1)

Ngarkesa – barra që bartet në automjetin ngarkues, e cila nën ndikim e dridhjeve apo faktorëve tjerë të jashtëm, mund të derdhët nëpër rrugë:

- duhet të bartet me shpejtësi jo më të madhe se 25 km/h
- duhet të bartet me shpejtësi jo më të madhe se 30 km/h
- duhet që gjatë bartjes deri më 5 persona ta mbajnë ngarkesën
- detyrimisht duhet të mbulohet me ceradë dhe të shtrëngohet mir për pjesët anësore të automjetit ✓

3 поени

670. (kat. II,II1)

Natën dhe ditën në raste të dukshmërisë së zvogëluar, pika më e nxjerrur e ngarkesës që bartet me automjetin ngarkues dhe e tejkalon për më shumë se një metër pikën më të largët të pjesës së prapme të automjetit, shënohet me:

- dritë dhe materie reflektuese me ngjyrë të kuqe ✓
- dritë dhe materie reflektuese me ngjyrë të verdhë
- pëlhurë të kuqe
- pëlhurë të verdhë

3 поени

671. (kat. II,II1)

Ngarkesa që vazhdimisht është e mbështetur mbi hapësirën ngarkuese, mund ta tejkalojë pikën më të largtë të pjesës së prapme të automjetit, më së shumti për:

- një gjysëm nga gjatësia e saj
- një të gjashtë e gjatësisë së saj ✓
- një të tretën e gjatësisë së saj
- një të katërtën e gjatësisë së saj

3 поени

672. (kat. II,II1)

Deri te hyrja e ajrit në instalimin hidraulik për frenimin e automjetit, mund të vijë për shkak të:

- sasisë së pamjaftushme të lëngut hidraulik në instalimin e pajisjes për frenim ✓
- përdorimit të tepërt të frenave
- disqeve të shtrembëruara të frenave
- shtresave të harxhuara të gurtneve

3 поени

673. (kat. II,II1)

Sistemi për navigacion, GPS (Sistemi Global Pozicional) shërben për:

- përmirësimin e sinjalit të radios në automjet
- frenim efikas dhe racional të automjetit
- orientim të shoferit gjatë drejtimit me automjetin ✓
- matjen e numrit të rrotullimeve në automjetin motorik

3 поени

674. (kat. II,II1)

Masa e përgjithshme e rimorkios nuk guxon të jetë më e madhe se masa e përgjithshme e automjetit tërheqës, për më tepër se:

- 60 %
- 50 % ✓
- 40 %
- 30 %

3 поени

675. (kat. II,II1)

Me tabelë për shënim të "automjeteve të rënda", duhet të jenë të shënuara automjetet motorike ngarkuese, masa më e madhe e të cilave është mbi:

- 7.500 kg
- 9.000 kg
- 11.000 kg
- 12.000 kg ✓

3 поени

676. (kat. II,II1)

Nëse vjen deri te ndarja e mjetit bashkëngjitës nga automjeti tërheqës:

- sistemi për frenim në mjetin bashkëngjitës do të kyçet automatikisht ✓
- retarderi e merr frenimin e mjetit bashkëngjitës
- do të aktivizohet frenimi motorik i mjetit bashkëngjitës
- sistemi i frenimit të mjetit tërheqës do të aktivizohet automatikisht

3 поени

677. (kat. II,II1)

Shoferi i cili ka marr leje të vozitjes të kategorisë "C" llogaritet si shofer-fillestar i asaj kategorie në periudhën kohore prej:

- dy vite pas marrjes së patentë shoferit ✓
- një vit pas marrjes së patentë shoferit
- gjatë muaj pas marrjes së patentë shoferit

3 поени

678. (kat. Ц,Ц1)

Në kategorinë “C” bëjnë pjesë automjete të ndryshme motorike nga ato të kategorisë “D”, ku masa e përgjithshme e të cilave është më e madhe se:

- 3.500 kg ✓
- 5.000 kg
- 7.500 kg

3 поени

679. (kat. Ц,Ц1)

Në kategorinë „C1” bëjnë pjesë automjetet motorike të ndryshme nga ato të kategorisë „D” ku masa e përgjithshme e të cilave është më e madhe se:

- 7.500 kg
- 5.000 kg, por jo më shumë se 9.500 kg
- 3.500 kg, por jo më shumë se 7.500 kg ✓

3 поени

680. (kat. Ц,Ц1)

Në kategorinë “C+E” bëjnë pjesë grupe automjetesh, ku automjeti tërheqës i së cilës bën pjesë në kategorinë “C”, në të cilën mund të shtohet mjet bashkëngjites ku masa e përgjithshme e së cilës është më e madhe se:

- 550 kg
- 650 kg
- 750 kg ✓

3 поени

681. (kat. Ц,Ц1)

Patentë shoferi ndërkombëtare jepet me afat vazhdimi prej:

- 1 viti
- 3 vitesh ✓
- 5 vitesh

3 поени

682. (kat. Ц,Ц1)

Në nënkategorinë “C1+E” bëjnë pjesë grupe automjetesh, ku automjeti tërheqës i së cilës bën pjesë në nën kategorinë “C1”, ndërsa mjeti bashkëngjites është me masë më të madhe se 750 kg, me atë që masa e përgjithshme e grupit të automjeteve:

- nuk e tejkalon mbi 7.500 kg
- nuk e tejkalon mbi 10.000 kg
- nuk e tejkalon mbi 12.000 kg ✓

683. (kat. II,II1)

Transport të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor mund të bëjë personi i vendit, juridik apo fizik i cili ka:

- Leje për kryerjen e transportit të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor, të lëshuar nga ministria përkatëse ✓
- Licencë për kryerjen e transportit të mallrave në komunikacionin rrugor
- Leje për kryerjen e transportit të jashtëzakonshëm në komunikacionin rrugor

3 поени

684. (kat. II,II1)

Në komunikacionin rrugor, materie të rrezikshme mund të transportojnë persona, që janë të aftësuar për përdorim dhe transport të materieve të rrezikshme dhe që kanë mbushur:

- 21 vjet moshë ✓
- 20 vjet moshë
- 19 vjet moshë

3 поени

685. (kat. II,II1)

Lejen për kryerjen e transportit të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor, e jep:

- Ministria e shëndetësisë
- Ministria për transport dhe lidhje ✓
- Agjencioni për rrugët shtetërore në harmoni me Ministrinë e ekologjisë

3 поени

686. (kat. II,II1)

Në automjetin, në të cilin bëhet bartja e materieve të rrezikshme përskaaj shoferit, ndihmës shoferit apo shoqëruesit, a guxojnë të gjenden edhe persona tjerë:

- guxojnë, deri tre persona për ngarkim dhe shkarkim të barrës
- guxon, vetëm edhe një person për ngarkim dhe shkarkim
- nuk guxojnë të gjenden persona të tjerë ✓

3 поени

687. (kat. II,II1)



Automjetet transportuese të mallrave (të treguara në fotografinë), të cilat lëvizin në rrugë publike jashtë vendbanimit, që ka vetëm nga një korsi komunikacioni në një kahe dhe nëse në atë pjesë të rrugës është i ndaluar parakalimi:

- shoferët janë të obliguar që të lëvizin me automjetet në distancë të sigurtë ✓
- shoferët janë të obliguar që të mbajnë distancë ndërmjet automjeteve më së paku 50 metra
- shoferët janë të obliguar që të mbajnë distancën ndërmjet automjeteve më së paku prej 100 metra

5 поени

688. (kat. II,II1)



Shoferi i automjetit transportues të mallrave, ku masa më e madhe e lejuar e së cilës është më e madhe se 3.500 kg, kur qarkullon në rrugë publike në vendbanim (si në fotografinë), në të cilën ekzistojnë më së paku dy korsi komunikacioni për lëvizje në të njëjtën kahe:

- është i obliguar që të qarkullojë nëpër korsinë e komunikacionit përkaj tehut të djathtë të rrugës automobilistike ✓
- është i obliguar që ta shfrytëzojë korsinë e komunikacionit që gjendet përkaj tehut të majtë të rrugës automobilistike
- mund të qarkullojë sipas zgjedhjes së lirë në korsinë e majtë apo të djathtë të komunikacionit

5 поени

689. (kat. II,II1)



Shoferi i automjetit transportues të mallrave, i cili qarkullon nëpër korsinë e majtë të komunikacionit në rrugë jashtë vendbanimit (si në fotografinë):

- në mënyrë jo të rregullt bën parakalimin sipas sinjalizimit horizontal të rrugës
- gjatë parakalimit është i obliguar, që automjetin e vet ta mbajë në distancën e nevojshme nga automjeti që e parakalon ✓
- nuk guxon të fillojë me parakalimin në këtë pjesë të rrugës

5 поени

690. (kat. Ц,Ц1)



Në pjesët e jashtme të automjetit motorik (të treguar në fotografi) mund të barten vetëm persona:

- që punët në vendet e tyre të punës i kryejnë në atë automjet ✓
- në relacione të shkurtra deri më 500 metra
- në rrugëkalim me intensitet më të dobët të komunikacionit

5 поени

691. (kat. Ц,Ц1)



Shoferi i automjetit transportues të mallrave (të treguar në fotografinë), ku pika më e nxjerrur e ngarkesës, e cila e tejkalon më tepër se një metër nga pika më e largët e pjesës së prapme të automjetit:

- në mënyrë të rregullt e shënon me tabelë në formë katrori, të ngjyrosur me vija të pjerrëta paralele me ngjyrë reflektuese portokalli dhe të bardhë ✓
- e ka shënuar në mënyrë jo të rregullt, me qenë se është dashur që ta përdorë trekëndëshin e sigurisë
- e ka shënuar në mënyrë jo të rregullt, me qenë se është dashur të përdorë pëlhurë të kuqe

5 поени

692. (kat. Ц,Ц1)



Shoferi i automjetit transportues të mallrave në një pjesë të rrugës së treguar si në fotografinë, është i ndalur:

- në mënyrë të rregullt përskaj tehut të djathtë të rrugës
- në mënyrë të rregullt, me qenë se shenja ka të bëjë vetëm për veturat
- në mënyrë jo të rregullt ✓

5 поени

693. (kat. Ц,Ц1)



Pika më e nxjerrë e ngarkesës, që bartet me automjet motorik ngarkues (si në fotografi), nëse e tejkalon për më tepër se një metër pikën më të largët nga ana e prapme e automjetit, shënohet me tabelë me dimensione:

- 50 x 50 cm ✓
- 50 x 40 cm
- 40 x 40 cm

5 поени

694. (kat. Ц,Ц1)



Shoferi i automjetit motorik ngarkues, të cilit i është dhënë shenjë për parakalim nga vetura (si në fotografi), është i obliguar:

- ta lëvizë automjetin e vet kah tehu i djathtë i rrugës ✓
- ta zvogëlojë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të vet
- ta ndalojë automjetin në vend të përshtatshëm të rrugës

5 поени

695. (kat. Ц,Ц1)



Kur “një grup automjete” është ndalur në rrugë, freri i parkimit duhet të sigurojë jo lëvizjen e tërë grupit të automjeteve, ndërsa gjatë saj grupi i automjeteve të mos ketë frenuar në tjetër mënyrë (si në fotografi), gjatë pjerrtësisë prej:

- 12 %
- 10 %
- 8 % ✓

5 поени

696. (kat. II,II1)



Në rrugë publike të dedikuar për komunikacion në të dyja kahet (si në fotografi), shoferi i automjetit motorik ngarkues:

- në mënyrë të rregullt e ka parkuar automjetin e vet jashtë rrugës
- në mënyrë të rregullt e ka ndaluar automjetin e vet në parking, përskaj anës së majtë të rrugës në drejtim të lëvizjes
- në mënyrë të parregullt ka kaluar nga ana e majtë e rrugës në drejtim të lëvizjes, që ta parkojë automjetin e vet ✓

5 поени

697. (kat. II,II1)

Takograf të instaluar patjetër duhet të kenë të gjitha automjetet motorike, ku masa më e madhe e tyre e lejuar është më e madhe se:

- 3.000 kg
- 3.500 kg ✓
- 5.000 kg

3 поени

698. (kat. II,II1)

``Pushimi javor`` është pushim i shoferit, që është i obliguar të pushojë gjatë javës në kohë zgjatje prej:

- 35 orë pa ndërprerë
- 45 orë pa ndërprerë ✓
- 55 orë pa ndërprerë

3 поени

699. (kat. II,II1)

Pas katër orësh e gjysmë vozitjeje pa ndërprerë, shoferi është i obliguar të bëjë ndërprerje me drejtimin e automjetit më së paku:

- 45 min. ✓
- 30 min.
- 15 min.

3 поени

700. (kat. II,II1)

Takografët që janë të instaluar në automjetet mund të jenë:

- analogë dhe digjitalë ✓
- manualë
- automatikë

3 пени

701. (kat. II,II1)

Takografët digjitalë shfrytëzojnë:

- shirita takografik
- shirita rollnë (rrotull)
- kartelë memorie ✓

3 пени

702. (kat. II,II1)

Kontrollimi dhe bazhdarimi i takografëve bëhet njëherë në:

- 6 muaj
- 12 muaj
- 24 muaj ✓

3 пени

703. (kat. II,II1)

Kartela memoruese e shoferit për takograf digjital, jepet me afat vazhdimi prej:

- një viti
- tre vitesh
- pesë vitesh ✓

3 пени

704. (kat. II,II1)

Pas vozitjes së pandërprerë prej katër orësh e gjysmë, shoferi që drejton me automjetin motorik ngarkues, masa më e madhe e lejuar, e të cilit është më e madhe se 3. 500 kg, është i detyruar që të bëjë ndërprerje të vozitjes më së paku për 45 minuta, apo më shumë ndërprerje prej:

- më së paku 10 minuta, nga e cila kohë zgjatje nuk guxon të jetë më e vogël se 40 minuta
- më së paku 15 minuta, nga e cila kohëzgjatje nuk guxon të jetë më e vogël se 30 minuta
- më së paku 15 minuta, nga e cila kohëzgjatje përgjithshme nuk guxon të jetë më e vogël se 45 minuta ✓

3 пени

705. (kat. Ц,Ц1)

Shoferi që drejton me automjet motorik ngarkues, apo me grup automjetesh, masa më e madhe e lejuar e të cilit është më e madhe se 3.500 kg, në kohë prej 24 orësh me atë automjet nuk guxon të drejtojë më gjatë se:

- katër orë vozitje të pandërprerë
- katër orë e gjysmë vozitje të pandërprerë ✓
- pesë orë vozitje të pandërprerë

3 поени

706. (kat. Ц,Ц1)

Koha e drejtimit ditor me automjetin motorik ngarkues, nuk guxon të jetë më e gjatë se:

- tetë orë
- nëntë orë, me përjashtim të vazhduar në 10 orë, por jo më shumë se dy herë në javë ✓
- 11 orë, me përjashtim të vazhduar në 12 orë, por jo më shumë se dy herë në javë

3 поени

707. (kat. Ц,Ц1)

Lejën për transport grupor të udhëtarëve me automjet transportues të mallrave e jep:

- Stacioni për kontrollim teknik të automjeteve
- Ministria e Punëve të Brendshme ✓
- Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve

3 поени

708. (kat. Ц,Ц1)

Me automjet transportues të mallrave, masa e të cilit është më e madhe se 3.500 kg, me të cilin bëhet bartje grupore e udhëtarëve mund të drejtojë:

- shoferi i cili drejtimin me automjetin motorik e ka profesion primar dhe i cili më së paku tre vite drejton me automjet të asaj kategorie ✓
- shoferi, i cili më së paku dy vite ka drejtuar me automjet të kategorisë "C"
- shoferi, i cili më së paku pesë vite ka drejtuar me automjet të kategorisë "B"

3 поени

709. (kat. Ц,Ц1)

Automjetet transportuese të mallrave dhe autobusët në pajisjen e tyre të obliguar duhet të kenë:

- një trekëndësh të sigurisë ✓
- dy trekëndësha të sigurisë
- një tabelë kotrore për automjet të ndalur në rrugë

3 поени

710. (kat. II,II1)

Kontrollim dhe kalibrim të takografëve bën:

- organi administrativ në fakulltetin makinerik
- person juridik (puntori) e autorizuar nga Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve ✓
- Ministria e Punëve të Brendshme

3 поени

711. (kat. II,II1)

Gjatësia më e madhe e lejuar e automjetit për transport të mallrave, është:

- 6 m
- 10 m
- 12 m ✓

3 поени

712. (kat. II,II1)

Mjetet bashkëngjitime në pjesën e prapme patjetër duhet të kenë 2 katadiopterë në formë të trekëndëshit barabrinjës me:

- ngjyrë të bardhë
- ngjyrë të kuqe ✓
- ngjyrë të verdhë

3 поени

713. (kat. II,II1)

Automjetet, shpejtësia më e madhe e lejuar e të cilave është e kufizuar me kufizues për shpejtësi, në hapësirën për vozitësin, duhet të jenë të pajisura me:

- pajisje të posaçme për dhënien e sinjaleve të zëshme gjatë arritjes së shpejtësisë më të madhe të lejuar
- sinjal ndriçues me ngjyrë të kuqe, i cili kyçet në instrument tabelë gjatë arritjes së shpejtësisë më të madhe të lejuar
- tiketë të posaçme të ngjitur mirë të dukshme, e cila e informon shoferin për shpejtësinë më të madhe të caktuar ✓

3 поени

714. (kat. II,II1)

Kontrollim të rregullt teknik, automjetit motorik ngarkues i bëhet në:

- automjet të ngarkuar deri më 1.500 kg, bashkë me shoferin dhe me pajisjen e obliguar të automjetit
- automjet të zbrazët me shoferin dhe pajisjen e obliguar të automjetit ✓
- automjet të ngarkuar deri më tre ton, bashkë me shoferin dhe me pajisjen e obliguar të automjetit

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



715. (kat. Ц,Ц1)

Në pajisjen e posaçme , që duhet ta kenë automjetet, të cilat bartin materie të rrezikshme , bëjnë pjesë edhe dy llamba dore - bateri, që japin dritë me:

- ngjyrë portokalli ✓
- ngjyrë të bardhë
- ngjyrë të kuqe

3 поени

716. (kat. Ц,Ц1)

Automjetet që nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara në lidhje me përmasat, masën e përgjithshme dhe boshtin e ngarkesës , mund të marrin pjesë në komunikacion nëse kanë:

- pneumatikë të posaçëm për ngarkesa (barra) të rënda dhe shenjë në formë trekëndëshi
- tiketë të posaçme apo tabelë për vozitje provuese
- leje për transport të jashtëzakonshëm ✓

3 поени

717. (kat. Ц,Ц1)

``Dukshmëri e zvogëluar`` ekziston, nëse për shkak të kushteve atmosferike të pavolitshme, shoferi nuk mund qartë t'i vërejë pjesëmarrësit tjerë në komunikacion në largësi prej më së paku:

- 300 metra në rrugë jashtë vendbanimit
- 200 metra në rrugë jashtë vendbanimit ✓
- 250 metra në rrugë jashtë vendbanimit

3 поени

718. (kat. Ц,Ц1)

Shoferi nuk guxon ta ndalojë apo ta parkojë automjetin para ose pas shenjës me të cilën është shënuar vend pritja e automjeteve të komunikacionit publik të qytetit në largësi më të vogël se:

- 5 metra
- 10 metra
- 15 metra ✓

3 поени

719. (kat. Ц,Ц1)

Rrezet ndriçuese të dritave të gjata të automjetit, patjetër duhet ta ndriçojnë rrugën prej më së paku:

- 40 metra para automjetit
- 80 metra para automjetit
- 100 metra para automjetit ✓

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



720. (kat. II,II1)

Dy drita gabarite të para dhe dy të pasme, patjetër duhet t'i kenë të gjitha automjetet dhe mjetet bashkëngjitëse të cilat janë të bëra me mbindërtim të mbyllur, lartësia e së cilës e tejkalon:

- 1,8 m
- 2.8 m ✓
- 3.8 m

3 поени

721. (kat. II,II1)

Drita- stop nuk është patjetër të kenë automjetet, të cilat në rrugë të rrafshhtë nuk mund të zhvillojnë shpejtësi lëvizëse më të madhe se:

- 10 km/h
- 20 km/h ✓
- 30 km/h

3 поени

722. (kat. II,II1)

``Dukshmëri e zvogëluar`` ekziston, nëse për shkak të kushteve atmosferike të pavolitshme, shoferi nuk mund qartë t'i vërejë pjesëmarrësit tjerë në komunikacion në largësi prej më së paku:

- 200 metra në rrugë në vendbanim
- 100 metra në rrugë në vendbanim ✓
- 150 metra në rrugë në vendbanim

3 поени

723. (kat. II,II1)

Tregues të drejtimit (vezullues) të dukshëm nga pjesët anësore, patjetër duhet të kenë automjetet motorike që janë më të gjata se:

- katër metra
- pesë metra
- gjashtë metra ✓

3 поени

724. (kat. II,II1)

Gjatë kohës së drejtimit me automjet në rrugë, shoferi duhet t'i ketë të ndezura:

- dritat për shënimin e automjetit
- dritat për mjegull
- së paku dritat e mesme ✓

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



725. (kat. II,II1)

Distanca ndërmjet automjetit tërheqës dhe të tërhequr në defekt, kur tërhiqet me lidhje të fortë (bigë), mund të jetë edhe më e vogël se:

- tri metra ✓
- katër metra
- pesë metra

3 поени

726. (kat. II,II1)

Aktivizimi i ngadalësuesit motorik (bllokazhës) te automjeti bëhet me:

- trusje të shpeshta të padalës së frerit të punës
- mbylljen e granës fryrëse të motorit dhe shkyçjen e përcjelljes së lëndës djegëse në cilindrin e motorit ✓
- përdorimin e frerit ndihmës

3 поени

727. (kat. II,II1)

Kur në rrugën publike jashtë vendbanimit, që ka vetëm nga një korsi komunikacioni në një kahe, ku qarkullojnë automjete motorike njëra pas tjetrës, masa më e madhe e lejuar e të cilave është më shumë se 3500 kg dhe gjatësia e së cilës është më e madhe se 7 metra, shoferët janë të obliguar ndërmjet automjeteve:

- të mbajnë distancë prej më së paku 50 metra
- të mbajnë distancë prej më së paku 100 metra ✓
- të mbajnë distancë prej më së paku 200 metra

3 поени

728. (kat. II,II1)

Te automjetet për transport të mallrave, në vendin për vendosjen e ngarkesës:

- nuk guxon të barten persona
- mund të barten më së shumti pesë persona të cilët punojnë në ngarkim dhe shkarkim të mallit ✓
- mund të barten persona vetëm në rrugët lokale

3 поени

729. (kat. II,II1)

Në automjetin për transportim të mallrave, me shkarkues automatik:

- mund të barten më së shumti pesë persona
- mund të barten më së shumti tre persona
- nuk guxon barten persona ✓

3 поени

730. (kat. II,II1)

Në mjetin bashkëngjitur që e tërheq automjeti motorik:

- mund të barten deri më tre njerëz
- mund të barten deri më pesë njerëz
- nuk guxon të barten njerëz ✓

3 поени

731. (kat. II,II1)

Gjerësia më e madhe e lejuar e automjetit motorike, përveç automjeteve me izolim të ndërtuar për mbrojtje nga nxehtësia është:

- 2,35 metra
- 2,55 metra ✓
- 2,75 metra

3 поени

732. (kat. II,II1)

Obligim i detyrueshëm për bartjen e përgatitjeve dimërore në automjet, është në periudhën kohore prej:

- 15 dhjetor deri më 15 mars
- 15 nëntor deri më 31 mars
- 15 nëntor deri më 15 mars ✓

3 поени

733. (kat. II,II1)

Në automjetet me masë më të madhe të lejuar mbi 3.500 kg, të cilat arrijnë shpejtësi mbi 40 km/h, pneumatikët, që vihen në të njëjtin bosht duhet të jenë:

- të njëjta sipas dimensioneve
- identike në raport me pamjen (verore–dimërore)
- identike në raport me tipin, ndërtimin, madhësinë, kategoritë e bartjes dhe të shpejtësisë ✓

3 поени

734. (kat. II,II1)

Shtypja tepër e madhe në pneumatikët, e zvogëlon sipërfaqen shkelëse të pneumatikut me shtresën e rrugës, ndërsa me të edhe koeficienti i fërkimit sjell deri te:

- harxhimi i barabartë i tyre (brejtjen) nga shtresa shkelëse e larës
- harxhimi i tyre më i shpejtë (brejtjen) nëpër mjedis të larës ✓
- harxhimi jo i barabartë i tyre (brejtjen) në pjesët anësore të larave

3 поени

735. (kat. II,II1)

Në rast të evakuimit, të fatkeqësisë eventuale dhe të ngjashme, me automjet motorik ngarkues në sipërfaqen e dedikuar për vendosjen e barrës, pa shoqërimin e personit të moshës madhore nuk guxon të bëhet transport grupor i fëmijëve, më të rinj se:

- 14 vjeç ✓
- 12 vjeç
- 10 vjeç

3 поени

736. (kat. II,II1)

Shtypja jo e mjaftueshme në pneumatikët e automjetit e zgjeron sipërfaqen shkelëse të pneumatikëve me sipërfaqen e rrugës dhe për shkak të fërkimit më të madh, njëkohësisht dhe të nxehjes së pneumatikëve, vjen deri te:

- harxhimi i tyre (brejtja) nëpër mes të larave
- zmadhimi i harxhimit të tyre (brejtja) nga pjesët anësore të larës ✓
- harxhimi i barabartë i tyre (brejtja) nëpër shtresën shkelëse (të fërkimit) të larës

3 поени

737. (kat. II,II1)

Pajisja servo e drejtuesit të automjetit motorik instalohet për shkak të:

- mbrojtjes së pajisjes për drejtim nga dëmtimet
- mbrojtjes so shoferit gjatë aksidentit eventual me automjetin
- zvogëlimin të fuqisë së nevojshme të vozitësit gjatë drejtimit me timonin e automjetit ✓

3 поени

738. (kat. II,II1)

Lëvizja e lirë (llufti) e timonit të automjetit motorik guxon të jetë më së shumti:

- 20 shkallë
- 30 shkallë ✓
- 40 shkallë

3 поени

739. (kat. II,II1)

Në raste kur timoni lëvizë rënd, gjegjësisht shoferi përdor forcë më të madhe gjatë sjelljes, shkak i saj është:

- bllokimi i rrotave të boshtit të përparëm
- mosfunksionimi i pajisjes servo ✓
- ankth i tepërt i nyjeve lidhëse të drejtimit

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



740. (kat. Ц,Ц1)

Gjatë përdorimit të frenit punues dhe ndihmës të automjeti motorik dhe mjetit bashkëngjithës, dallimi i forcës së frenimit mbi rrotat e të të njëjtit bosht, nuk guxon të jenë më e madhe se:

- 10%
- 20% ✓
- 30%

3 поени

741. (kat. Ц,Ц1)

Çka paraqet retarderi:

- pajisje për ngadalësim afatgjatë të automjetit ✓
- pajisje për rregullimin e rrotullimeve të rrotave të automjetit
- pajisje për përshpejtim plotësues të automjetit

3 поени

742. (kat. Ц,Ц1)

Sistemin për frenim te automjetet motorike e përbëjnë:

- freni ndihmës dhe freni parkues
- retarderi dhe freni parkues
- freni punues, freni ndihmës dhe ai parkues ✓

3 поени

743. (kat. Ц,Ц1)

Sistemi anti bllok (ABS) e rregullon fuqinë e frenimit të rrotave në varshmëri me:

- shpejtësinë e lëvizjes dhe barrës të automjet
- numrin momental të rrotullimeve të rrotës ✓
- forcën që vepron mbi pedalen e frenimit

3 поени

744. (kat. Ц,Ц1)

Freri ndihmës te automjeti duhet të mundësojë:

- ndaljen e automjetit nëse dështon freri punues ✓
- ngadalësim të automjetit gjatë frenimit motorik teposhtë
- efikasitet më të madh të frerit punues gjatë ndaljes së automjetit

3 поени

745. (kat. II,II1)

Nxehja e frerëve të rrotave të automjetit, sjell deri te:

- frenimi më i sigurt i automjetit me zë depërtues (fishkëllimë) gjatë kohës së frenimit
- kontakti më i mirë i pneumatikëve me shtresën e rrugës gjatë frenimit
- vazhdimi në rrugën e frenimit ✓

3 поени

746. (kat. II,II1)

Frenimi punues i mjetit bashkëngjitës patjetër duhet të fillojë:

- një deri më tre sekonda pas frenimit të automjetit tërheqës
- tre deri më pesë sekonda pas frenimit të automjetit tërheqës
- njëkohësisht apo para frenimit të automjetit motorik tërheqës ✓

3 поени

747. (kat. II,II1)



Shpejtësia e lëvizjes së automjetit transportues të mallrave, ku masa më e madhe e lejuar e të cilit është më e madhe se 7.5000 kg (e treguar në fotografi), kur qarkullon në rrugë publike, kufizohet në:

- 90 km/h
- 80 km/h
- 70 km/h ✓

5 поени

748. (kat. II,II1)



Shpejtësia e lëvizjes së automjetit transportues të mallrave, ku masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk është më e madhe se 7.5000 kg (e treguar në fotografi), kur qarkullon në rrugë publike, kufizohet në:

- 90 km/h
- 80 km/h ✓
- 70 km/h

5 поени

АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA



749. (kat. Ц,Ц1)



Shpejtësia e lëvizjes së automjetit transportues të mallrave, ku masa më e madhe e lejuar e të cilit është më e madhe se 7.5000 kg (e treguar në fotografi), kur qarkullon në autostradë, kufizohet në:

- 80 km/h ✓
- 90 km/h
- 100 km/h

5 поени

750. (kat. Ц,Ц1)



Shpejtësia e lëvizjes së automjetit transportues të mallrave, ku masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk është më e madhe se 7.5000 kg (e treguar në fotografi), kur qarkullon në autostradë, kufizohet në:

- 80 km/h
- 90 km/h ✓
- 100 km/h

5 поени

751. (kat. Ц,Ц1)



Shoferi i automjetit motorik me të cilin barten materje të rrezikshme, kur qarkullon në autostradë si në fotografinë, nuk guxon të lëvizë me shpejtësi:

- më të madhe se 100 km/h
- më të madhe se 80 km/h
- më të madhe se 70 km/h ✓

5 поени

752. (kat. Ц,Ц1)



Automjeti motorik, i cili është i dedikuar për bartjen e materjeve të rrezikshme (si në fotografinë) patjetër duhet të jet i shënuar me dy tabela, që vendosen në pjesën e parme dhe të pasme të automjetit, të cilat janë në formë të:

- trekëndëshit barabrinjës me materie reflektuese me ngjyrë të verdhë
- trekëndëshit barabrinjës me materie reflektuese me ngjyrë të kuqe
- trekëndëshit barabrinjës me materie reflektuese me ngjyrë portokalli ✓

5 поени

753. (kat. Ц,Ц1)



Sipas situatës së treguar në fotografi, shoferi automjetit motorik ngarkues:

- nuk guxon të vazhdojë me lëvizjen nëpër rrugë
- guxon të vazhdojë me lëvizjen nëpër rrugë ✓
- mund të vazhdojë me lëvizjen nëpër rrugë, në qoftë se ka leje për transport të jashtëzakonshëm

5 поени

754. (kat. Ц,Ц1)



Për shkak të teposhtës së rrezikshme të rrugës, shoferi i automjetit ngarkues, i cili lëvizë më ngadalë sesa automjetet që lëvizin pas tij, (të treguar në fotografi):

- është i obliguar që të ndalet në vend të përshtatshëm të rrugës, me të cilën do të mundësojë lëshimin e automjeteve më të shpejta ✓
- nuk ka obligim ndaj kolonës së automjeteve që është krijuar pas tij
- është i obliguar që ta largojë automjetin në të majtë në korsinë e komunikacionit dhe të mundësojë lëshimin e automjeteve më të shpejta

5 поени

755. (kat. Ц,Ц1)



Sipas situatës së treguar në fotografi, automjeti që tërhiqet me varje, është me:

- me defekt të pajisjes për ndërrimin e shkallës së veprimt të shpejtësisë (transmisionit)
- defekt të sistemit për ftohje të motorit
- defekt të pajisjes për drejtim dhe pajisjes për frenim

5 поени

756. (kat. Ц,Ц1)



Për automjetet motorike, që transportojnë materie helmuese kur lëvizin në rrugë publike, shpejtësia e lëvizjes së tyre zvogëlohet në 80% nga shpejtësia më e madhe e lejuar e përcaktuar sipas llojit të rrugës, gjegjësisht sipas shpejtësisë së përcaktuar me shenjën e komunikacionit, por jo më shumë se:

- 60 km/h
- 70 km/h
- 80 km/h

5 поени



☎ 042 216 211 ☎ 070 370 200
📍 /autoshkollaart

www.art.com.mk



aftësimin e kandidatëve për drejtimin e të gjitha kategorive të vozitjes оспособување на кандидати за возачи на моторни возила од сите категории



☎ 042 216 211 ☎ 070 370 200
📍 /autoshkollaart

www.art.com.mk



aftësimin e kandidatëve për drejtimin e të gjitha kategorive të vozitjes АВТО ШКОЛА / AUTO SHKOLLA

